



Kjo fletëpalosje është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërgjegjësimi dhe forcimi i kapaciteteve në shërbimin social alternativ" pjesë e skemës së sub-granteve mbi "Zhvillimi i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për Familjet Kujdestare në Shqipëri" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në partneritet me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS). Përmbajtja e kësaj fletpalosje është përgjegjësi e Qendres për Administrim Social Ekonomik Territorial dhe këndvështrimet e autorëve jo domos-doshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) apo të SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Për më tepër informacion kontaktoni:

SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri

Rruga "Qemal Stafa" Pallati 1, Ap.15; P.O Box 1524,
Tirana, Albania

Telefon: +355 44 536901 .

E-mail: info@soskd.org.al

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet Agimi, Shk.18
Ap 322, Tirane, Albania

Telefon: +355 4 2253113 .

E-mail: tlas@tlas.org

Bashkia Tiranë

Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

Telefon: 0800 0888

E-mail: info@tirana.al

Qendra ASET

Rruga "Bardhyl", Pallatet Bifter & Co, Kati 2, Ap 2

Telefon: 0693113606

E-mail: info@asetcenter.al



**Bëhuni prindër
kujdestarë dhe
prekni jetën e
një fëmije**



Qendra për
Administrim Social
Ekonomik Territorial

Kush mund të aplikojë?

Familje që kanë shfaqur interes për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative ;
Anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qënë familje kujdestare ;
Anëtarët e familjes të mos kenë qënë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;
Prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit ;
Prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetetojnë me raport mjeko-ligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe nuk mbartin sëmundje të transmetueshme ;
Të sigurojnë dhe të garantojnë mjedis familjar të sigurtë për fëmijën;
Anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;
Të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërës apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi ;
Prindërit të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
Prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;
Prindërit kujdestarë nuk kanë humbur, nuk u është hequr përgjegjësia prindërore ose nuk u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër.
Prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;
Prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësi prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

Hapat për t'u bërë / Familje Kujdestare

Shfaqja e interesit për të qënë familje kujdestare pranë Bashkisë Tiranë, në zyrat e shërbimit social dhe plotësimi i dokumentacionit të kërkuar
Vlerësim i mëtejshëm i familjes nga punonjësi social dhe psikologu
Trajnim i familjes nga struktura përgjegjëse dhe vlerësimi i kapaciteteve dhe aftësive të tyre si prindër kujdestar
Pas trajnimit përgatitet raporti nga punonjësi social dhe psikologu dhe i dorëzohet komisionit multidisiplinar.
Vendimi i komisionit multidisiplinar i përcillet strukturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative ku banon familja kujdestare.
Pas plotësimit të të gjitha këtyre hapave ligjorë dosja bëhet gati për në Gjykatë nga ku do merret edhe vendimi për të qënë apo jo një familje kujdestare.
Pas marrjes së vendimit pozitiv punonjësi social përgjegjës bën përgatitjen paraprake të fëmijës
Fëmija përshtatet gradualisht në familjen kujdestare nëpërmjet vizitave dhe takimeve, numri i të cilave përcaktohet dhe realizohet rast pas rasti dhe është i kushtëzuar nga ritmi individual i përshtatjes së çdo fëmije.
Sistemohet fëmija në familjen kujdestare.
Monitorim në vazhdimësi nga njësia e vlerësimit të nevojave. Vizitat monitoruese kryhen në shtëpi fillimisht çdo dy javë dhe më pas çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.
Bashkia ofron 9000 lekë në muaj për ushqyerjen e fëmijës së vendosur në kujdestari, kurse për fëmijë me aftësi të kufizuar është 10000 lekë në muaj. Masa e financimit për familjen kujdestare për një fëmijë të vendosur në kujdestari është:
Shpenzime për veshmbathje 10 000 lekë në vit;
Shpenzime për shkollim 5 000 lekë në vit;
Shpenzime të tjera 10 000 lekë në vit.

Çfarë dokumentash duhen për aplikim?

Familja duhet t'i paraqesë Punonjësit Social këto dokumenta:
Raport mjeko-ligjor që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht.
Referencat për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja).
Punonjësi Social siguron dokumentat e mëposhtme:
Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
Vërtetim të gjëndjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;
Të ardhurat e familjes;
Pasuritë e paluajtshme të familjes;
Vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme me komunitetin;
Verifikimin social-ekonomik i familjes nga administrator shoqëror i njësisë administrative.
Përveç dokumentacionit të sipër përmendur punonjësi social dhe psikologu kanë detyrim ligjor të kryejnë:
Vizita në banesën e aplikantit për të verifikuar kushtet e jetesës së familjes kërkuese
Takimet individuale dhe në grup me të gjithë antarët e familjes së aplikantit;
Intervistat e personave të paraqitur nga aplikanti si referencë;
Intervista me specialistë të tjerë si punonjës policie, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor në vendbanimin e familjes kërkuese, punëdhënësin e bashkëshortit/es, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të komunitetit.